

KIZILYAPRAK kundër TURQISË

(kërkesa nr. 27528/95)

2 tetor 2003

kjo çështje kishte të bënte me dënimin e një botuesi dhe Gjykata vendosi se ky dënim përbënte shkelje të lirisë së tij të shprehjes

I. Faktet kryesore

1. Zeynel Abidin Kizilyaprak është shtetas turk që ka lindur më 1960 dhe jeton në Stamboll. Ai është pronar i një shtëpie botuese, Pelë Sor, e cila botoi një libër më 1991 të titulluar “Si ne luftuam kundër popullit turk! Kujtimet e një ushtari”, i cili përmbledhonte pikërisht kujtimet e një ushtari turk i cili kishte kryer shërbimin e tij ushtarak në juglindje të Turqisë.

2. Për shkak të botimit të këtij libri, Z. Kizilyaprak u dënua nga Gjykata e Sigurisë Kombëtare të Stambollit më 14 tetor 1993 me gjashtë muaj burg dhe me gjobë me argumentimin se bënte propagandë separatiste. Pas një amendimi ligjor në lidhje me propagandën, çështja i rihap por dënimi me burg i Z. Kizilyaprak u la në fuqi ndërsa gjoba u rrit. Kërkuesi iu drejta Gjykatës së Kasacionit. Kërkesa e tij përpara kësaj Gjykate për shkak se një ligj që sapo kishte hyrë në fuqi pezullonte ndjekjet penale dhe dënimet për vepra penale të kryera nga drejtorë shtëpish botuese. Pas vendimit të Gjykatës së Kasacionit, Gjykata e Sigurisë Kombëtare e rihapi çështjen dhe vendosi të jepte një dënim me kusht.

II. Vendimi i Gjykatës

3. Duke u bazuar në nenet 9 dhe 10 të Konventës, kërkuesi pretendonte se dënimi i tij kishte shkelur të drejtën e tij për lirinë e mendimit dhe të shprehjes. Ai ankohej gjithashtu, në bazë të Nenit 6 § 1 se ai nuk ishte gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme për shkak se në trupin gjykues të Gjykatës së Sigurisë Kombëtare kishte bërë pjesë edhe një gjyqtar ushtarak.

A. Në lidhje me Nenin 10

4. Gjykata vendosi që t’i merrte në shqyrtim ankesat në lidhje me nenet 9 dhe 10 në bazë të Nenit 10 pasi sipas një jurisprudence të vazhdueshme ky i fundit duket sikur përfshin në raste të tilla ankesat në bazë të Nenit 9. Gjykata konstatoi

që në fillim se dënimi i Z. Kizilyaprak përbënte një ndërhyrje ndaj së drejtës së tij për lirinë e shprehjes, por që ajo ndiqte një qëllim legjitim, pikërisht atë të mbrojtjes së integritetit territorial.

5. Në vijim Gjykata vlerësoi karakterin e nevojshëm të ndërhyrjes në një shoqëri demokratike. Ndërmjet të tjerash ajo theksoi se megjithëse disa pasazhe tepër të ashpra në libër jepnin një pamje tepër negative të shtetit turk dhe të ushtrisë turke dhe i jepnin botimit të karakter kundërshtues, ato nuk bënë nxitje për dhunë, për rezistencë të armatosur ose kryengritje, të cilat sipas pikëpamjes së Gjykatës, ishin një faktor thelbësor që duhej mbajtur parasysh.

6. Duke vlerësuar karakterin proporcional të masës, Gjykata konstatoi se autoritetet turke nuk e kishin mbajtur parasysh sa duhej të drejtën e publikut për t'u informuar nën një këndvështrim të ndryshëm në lidhje me gjendjen në juglindje të Turqisë. Përsa i përket ashpërsisë të dënimit ndaj Z. Kizilyaprak, Gjykata vuri në dukje se pezullimi i vendimit ndaj tij kushtëzohej me faktin që ai, në pozitën e botuesit, nuk duhej të kryente me qëllim një vepër tjetër për një periudhë tre vjeçare.

7. Për këto arsye Gjykata vendosi se dënimi i Z. Kizilyaprak nuk ishte në përputhje me qëllimet që ajo ndiqte dhe pra në tërësinë e saj nuk ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike". Për pasojë ajo arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të Nenit 10 të Konventës.

B. Në lidhje me Nenin 6

8. Në lidhje me ankimin për mungesën e pavarësisë dhe paanësisë të Gjykatës së Sigurimit Kombëtar, Gjykata e Strasburgut ritheksoi atë që kishte pohuar në raste të mëparshme në të cilat kishte marrë në shqyrtim aspekte të ngjashme. Sipas pikëpamjes së saj, fakti që një civil gjykohej nga një Gjykatë e Sigurimit Kombëtar ndër anëtarët e të cilës ishte edhe një ushtarak, përbënte një arsye legjitime që personi që gjykohej të dyshonte se gjykata nuk do të ishte e pavarur dhe as e paanshme. Për këtë arsye, Gjykata e Strasburgut vlerësoi se në gjykimin e kërkuesit Gjykata e Sigurisë Kombëtare nuk ishte një gjykatë e pavarur dhe e paanshme në kuptimin e Nenit 6 § 1 të Konventës dhe arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të këtij Neni.

C. Në lidhje me Nenin 41

9. Në bazë të Nenit 41 që ka të bëjë me shpërblimin e drejtë, Gjykata i akordoi Z. Kizilyaprak 3 000 euro shpërblim për dëmin jomaterial të pësuar dhe 2 500 për shpenzime ligjore.